

Zineta Asani, PhD¹
Nora Taravari, PhD²

UDC: 347.626:340.137(497.7:4-672EY)

**KONTRATA MARTESORE DHE TRAJTIMI I IMPLIKIMEVE
JURIDIKE DHE SOCIALE**

**БРАЧНИОТ ДОГОВОР И ТРЕТМАНОТ НА НЕГОВИТЕ ПРАВНИ
И СОЦИЈАЛНИ ИМПЛИКАЦИИ**

**THE MARRIAGE CONTRACT THE TREATMENT OF ITS LEGAL
AND SOCIAL IMPLICATIONS**

Abstract:

This paper examines the property regime and the role of the marriage contract as a potential legal instrument in the legislation of the Republic of North Macedonia, focusing on the existing legal gap in this area. The study analyzes the consequences of the absence of provisions allowing spouses to conclude marriage contracts regarding the regulation of property relations, and the resulting impact on the protection of the parties' rights and interests. Furthermore, it provides a comparative analysis of North Macedonian legislation with selected European legal systems, highlighting practices and legal instruments that ensure greater flexibility, clarity, and security for spouses. The research also explores theoretical and practical implications of introducing marriage contracts, considering social, economic, and legal perspectives. In this context, the study identifies alternative approaches and proposes recommendations for legislative reform aimed at aligning domestic law with European standards and trends in the field of property regimes and contractual arrangements between spouses. This analysis contributes to a better understanding of the challenges and opportunities associated with modernizing family law and enhancing legal certainty in marital property relations.

¹ Associate Professor, University AUE -FON, Skopje, zinet.asani@fon.edu.mk

² Ass. Professor, Mother Teresa University – Skopje, nora.taravari@unt.edu.mk

Keywords: *property regime, marriage contract, legal gap, European comparison, protection of rights, legal reform, family law, contractual arrangements etc.*

1. Koncepti teorik i “regjim pasuror martesor“

Martesa sjell si pasojë për bashkëshortët jo vetëm ndryshimin e statusit të tyre personal, por edhe ndryshimin e regjimit juridik që do t’i zbatohet pasurisë së fituar nga secili bashkëshort gjatë martesës, nëpërmjet zbatimit të të ashtuquajturit “regjim pasuror martesor”. Me regjim pasuror martesor kuptojmë tërësinë e normave ligjore, të cilat kanë për objekt rregullimin e marrëdhënieve pasurore ndërmjet bashkëshortëve gjatë martesës, dhe marrëdhënieve ndërmjet tyre dhe të tretëve³. Regjimi pasuror martesor përfshin të gjitha marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve që rrjedhin nga martesa ose nga zgjidhja e saj.⁴

Regjimi pasuror martesor në Republikën e Maqedonisë së Veriut rregullohet kryesisht me dispozitat e Ligjit të Familjes⁵, Ligjit për pronësi dhe të drejtat tjera sendore⁶, Ligjit për trashëgimi⁷. Ligji për familje përcakton mënyrën e menaxhimit, përdorimit dhe shpërndarjes së pasurisë së bashkëshortëve gjatë dhe pas martesës. Fusha e regjimit pasuror përfshin të drejtat dhe detyrimet e bashkëshortëve mbi pronën e përbashkët dhe pronën individuale, si dhe rregullon mënyrën e ndarjes së pasurisë në rast të shpërndarjes së martesës përmes divorcit. Legjislacioni aktual i Maqedonisë së Veriut nuk parasheh mënyrë alternative të regjimit pasuror martesor, pra, mundësinë e lidhjes të një kontrate martesore që do të përcaktonte regjime pasurore të veçanta për bashkëshortët. Kjo përbën një boshllëk ligjor në krahasim me shumicën e vendeve të Bashkimit Evropian, ku kontratat martesore janë të zakonshme dhe lejojnë fleksibilitet në rregullimin e marrëdhënieve pasurore ndërmjet bashkëshortëve, p.sh., në Francë dhe Gjermani⁸ ekzistojnë instrumente kontraktuale që mundësojnë ndryshimin e regjimit të

³ Omari, Sonila. E drejta familjare. Tiranë: Botimet Morava, 2010, f. 57.

⁴ Bariatti, Stefania. La famiglia nel diritto internazionale private comunitario. Milano: Giuffrè Editore, 2007, f. 538-539.

⁵ Ligji për familje i RM-së, Gazeta zyrtare e RM-së nr. 80/92, 9/96, 38/2004, 33/2006, 84/2008, 67/10, 156/10, 39/12, 44/12, 38/14, 115/14

⁶ Ligji për pronësi dhe të drejta tjera sendore i RM-së, Gazeta zyrtare e RM-së, nr. 18/2001, 92/2008

⁷ Ligji për trashëgimi i RM-së, Gazeta zyrtare e RM-së nr. 47/96

⁸ Bercovitz, S., Comparative Family Law in Europe, Oxford University Press, 2020, f. 102–110.

ligjshëm të pasurisë së përbashkët, duke u përshtatur me nevojat individuale të bashkëshortëve⁹. Në këtë mënyrë, sistemi francez dhe ai gjerman ofrojnë një mbrojtje më të madhe të të drejtave të palëve dhe parashikojnë qartësi në rast të shkëputjes së martesës. Pra, në legjislacionin vendas, regjimi i pasurisë martesore mbetet kryesisht ligjor dhe i standardizuar, pa hapësirë për marrëveshje individuale kontraktuale. Kjo kufizon fleksibilitetin e bashkëshortëve dhe mund të çojë në mosmarrëveshje në rast të divorcit ose shkëputjes së bashkëjetesës.

1.1 Evoluimi i regjimit pasuror midis bashkëshortëve

Në Romën e hershme, pater familias kishte një pozitë të lartë autoritare dhe epërsi ligjore mbi anëtarët e familjes. Gruaja hynte në familjen e burrit me martesë të tipit “*conventio in manum*”, duke humbur pasurinë dhe subjektivitetin juridik të familjes së origjinës. Pasuria e gruas kalonte në zotërim të burrit ose të pater familias-it të tij. Më vonë, u zhvillua martesë “*matrimonium sine manu*”, ku pasuria e bashkëshortëve mbetej e ndarë, duke përfshirë dy komponentë kryesorë: *dotën dhe dhurimet ob nuziale*. Në këtë formë, bashkëshortët ruanin pronësinë mbi pasuritë e tyre, ndërsa burrit i njihej vetëm drejtimi mbi dotën. Sendet e fituara gjatë martesës supozoheshin pronë e burrit sipas prezumimit “*muciana*”¹⁰.

Në shoqëritë feudale, marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve shërbenin kryesisht për të ruajtur pronësinë latifondiste dhe pushtetin politik të familjes. Pasuria e paluajtshme mbetej në pronësi të bashkëshortes, ndërsa bashkëshorti fitonte posedimin *jure uxorio* mbi të. Në sistemet romano-gjermane, si Italia, Franca, Gjermania, Zvicra, regjimi pasuror bazohej mbi pasuri të ndara dhe *dotën*, me administrimin e pasurisë dotale në dorë të bashkëshortit¹¹. Revolucioni industrial solli zhvlerësimin e pronësisë latifundiste dhe ristrukturimin e familjes si një njësi konsumimi, duke i dhënë rëndësi pasurisë së luajtshme dhe fitimeve ekonomike. Ky ndryshim ndikoi në rimodelimin e regjimeve pasurore, duke futur detyrimin e përbashkët për mbajtjen e familjes dhe rregulla për administrimin e pasurisë së fituar gjatë martesës¹².

⁹ Kovačević, M., *Porodično pravo*, Beograd, 2018, f. 75–80; Dubois, P., *Le droit patrimonial de la famille*, Paris, 2017, f. 60–65.

¹⁰ The Max Planck Encyclopedia of European Private Law. Vol. II, J. Basedow, K.J. Hopt, R. Zimmermann, A. Stier (Eds.), Oxford: University Press, 2012, f. 445.

¹¹ Garofalo, I *rapporti patrimoniali tra coniugi nel diritto internazionale privato*, f. 20-21

¹² Po aty, f.23

Në shtetet socialiste, barazia formale e burrit dhe gruas u bë themeli i së drejtës familjare, duke eliminuar elementet patriarkale dhe ndikimin e fesë. Regjimi pasuror favorizoi bashkësinë universale të pasurisë, me administrimin e përbashkët nga të dy bashkëshortët, duke mohuar të drejtën e vetërregullimit të regjimit martesor¹³.

Kjo analizë e shkurtër historiko-juridike tregon se regjimet pasurore martesore kanë evoluuar nga kontrolli absolut i burrit dhe familjes së tij mbi pasuritë, drejt një barazie të shtuar dhe ndarjeje më të drejtë të pasurive, si pasojë e ndryshimeve ekonomike, sociale dhe ideologjike në shoqëri.

2. Regjimi kontraktual i pasurisë midis bashkëshortëve dhe vlerat juridike të kontratës martesore

Me reformat e reja të të drejtës martesore, regjimi kontraktual i pasurisë bashkëshortore meriton një vëmendje dhe trajtim të veçantë, sepse u mundëson të drejtën bashkëshortëve, si rregull i përgjithshëm, të zgjedhin një regjim pasuror që më mirë i përgjigjet interesave të tyre, ose të lejojnë zbatimin e normave ligjore, që rregullojnë regjimin ligjor të bashkësisë martesore, si përjashtim nga rregulli i përgjithshëm¹⁴. Gati në të gjithë legjislacionet e shteteve të Bashkimit Evropian, ky rregullim i pasurisë bashkëshortore u jep një të drejtë të gjerë vendim-marrje bashkëshortëve, për të vendosur që marrëdhëniet e tyre pasurore të rregullohen nga një regjim pasuror kontraktor nga ata të rregulluar mes bazës ligjore.¹⁵

Vështuar në retrospektivë, regjimi kontraktual që rezulton me kontratën martesore si instrument ligjor nuk njihet vetëm në legjislacionet moderne. Në të kaluarën kontratat martesore kanë qenë shumë më të zakonshme ndërmjet bashkëshortëve, në krahasim me ditët tona. Historikisht, kontratat martesore e lidhura nga prindërit ose familjarët e tjerë të bashkëshortëve kanë qenë më të përhapura se kontratat martesore të lidhura nga vetë bashkëshortët, për arsye se, në shumë sisteme ligjore, gruaja për një kohë të gjatë nuk gëzonte zotësinë për të lidhur kontrata.

¹³ Rheinstein dhe Glendon, "Interspousal Relations." f. 73-74.

¹⁴ Russo, Le convenzioni matrimoniali ed altri saggi sul nuovo diritto di famiglia, f. 153;

¹⁵ Cassano, Giuseppe. "Il diritto di famiglia nei nuovi orientamenti giurisprudenziali II, Il regime patrimoniale della famiglia." në Trattati, P. Cendon, Milano: Giuffrè Editore, 2006, f. 345

2.1 Natyra juridike e kontratës martesore

Bazuar në teorinë juridike ekzistojnë përkufizime të ndryshme mbi kontratën e martesës. Ajo që është e përbashkët në opinionet doktrinale, është shprehja e vullnetit midis bashkëshortëve që regjimin ligjor mbi pasurinë e tyre ta modifikojnë në regjim pasuror kontraktual. Kjo mundëson të jepet një përkufizim i përgjithshëm mbi këtë akt ligjor të lidhur midis bashkëshortëve. Pra, “Kontrata martesore nënkupton marrëveshtjen nëpërmjet të cilës bashkëshortët sipas autonomisë të vullnetit të tyre që u njihet nga e drejta objektive, përjashtojnë ose modifikojnë rregullimin ligjor dhe e zëvendësojnë atë me një tjetër regjim kontraktor në bashkësinë martesore”¹⁶. Në kategorinë e kontratave martesore përfshihet çdo marrëveshje e bashkëshortëve, e cila ka për objekt rregullimin e marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve dhe vendosjen e pasurisë së tashme dhe të ardhshme të bashkëshortëve, apo të disa sendeve të caktuara, nën një regjim të caktuar juridik, që rregullon titullarin e pronësisë, administrimin dhe disponimin e saj¹⁷.

Kontrata martesore paraqitet si shprehje e vullnetit të bashkëshortëve për rregullimin e regjimit pasuror dhe për ndryshim nga kontratat tjera të zakonshme nuk prodhon efekte të menjëhershme reale apo detyrimi për palët¹⁸. Kjo kontratë që shpesh njihet si një skicë apo programim i pasurisë të bashkëshortëve, përveç rregullimit të regjimit pasuror, mund të përmbajë edhe të tjera marrëveshje (kontrata) me përmbajtje pasurore, të cilat mund të kenë për objekt rregullimin e pasojave pasurore të një zgjidhjeje apo pavlefshmërie eventuale martese, kontributin material për nevojat e familjes, dhurimet ndërmjet bashkëshortëve etj.. Kjo kontratë është akt juridik i dyanshëm i lidhur midis të fejuarve ose bashkëshortëve, që ka për qëllim të rregullojë marrëdhëniet pasurore midis tyre gjatë martesës dhe pas ndarjes së saj. Natyra juridike e kësaj kontrate mund të analizohen nga disa aspekte:

Karakteret kontraktual- Kontrata martesore bazohet në parimin e autonomisë së vullnetit, i cili lejon palët të rregullojnë vetë raportet e tyre pasurore, brenda kufijve të ligjit¹⁹. Kjo e bën atë instrument të vetëdijshëm dhe të qëllimshëm, ku bashkëshortët zgjedhin regjimin

¹⁶ Po aty

¹⁷ Cubeddu, Maria G. “Le convenzioni matrimoniali.” në I rapport patrimoniali tra coniugi III, T. Auletta (Ed.) në Trattati di diritto private, M. Bessone (Ed.), Torino: Giappichelli Ed., 2000, f. 28.

¹⁸ Flour dhe Champenois, Le régimes matrimoniaux, f. 145

¹⁹ Zweigert, K. & Kötz, H., Introduction to Comparative Law, 1998, f. 203.

pasuror që do të zbatohet: pasuri e përbashkët, pasuri e veçantë, ndarje e fitimeve, ose regjime të tjera të përshtatura sipas legjislacionit vendor.

Karakteri personal dhe pasuror- Kontrata martesore ka natyrë dypalëshe dhe lidh statusin personal me pasurinë, duke bërë diferencimin midis pasurisë së përbashkët dhe asaj personale. Megjithatë, ajo nuk rregullon marrëdhënie personale, si të drejtat dhe detyrimet personale bashkëshortore, që mbeten brenda juridiksionit të martesës²⁰

Karakteri dispozitiv dhe preventiv- Kontrata martesore është dispozitive, që do të thotë se palët kanë liri të zgjedhin rregullimin e marrëdhënieve të tyre pasurore, në masën që ligji nuk e ndalon. Po ashtu, ajo ka një rol preventiv, sepse parashikon situatat e mundshme të ndarjes ose divorcit dhe e zvogëlon riskun e mosmarrëveshjeve gjyqësore.

Karakteri formal dhe juridikisht i detyrueshëm- Për të qenë e vlefshme, kontrata martesore duhet të jetë në formën aktit noterial, duke iu nënshtruar rregullave të legjislacionit civil dhe familjar²¹. Kjo i jep kontratës natyrën juridikisht të detyrueshme dhe lejon ekzekutimin e saj përmes gjykatave ose noterisë.

Karakteri krahasues ndërkombëtar- Në sistemet e të drejtës kontinentale (Gjermani, Francë, Itali, Slloveni), kontrata martesore gjithashtu konsiderohet si instrument privat i marrëveshjes, por i rregulluar nga ligji për të mbrojtur palën më të dobët dhe për të garantuar transparencë pasurore⁽²²⁵⁾. Kjo thekson se natyra juridike e kontratës martesore kombinon elemente autonomie private, sigurie juridike dhe mbrojtjeje sociale.

Kontrata martesore sjell efekte juridike për të ardhmen, në kuptimin që rregullon regjimin juridik të transaksioneve që do të bëjnë bashkëshortët në të ardhmen. Rregullimi kontraktor i marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve është i lidhur me mbrojtjen e interesave të caktuara pasurore të secilit prej tyre²³. Interesi i parë qëndron në shpërndarjen e pasurisë brenda familjes, që do të thotë shpërndarje e pasurisë apo shpërndarjen e të ardhurave që fiton secili bashkëshort nëpërmjet punës së tij apo të ardhurave që fiton nga administrimi i pasurisë personale. *Së dyti*, si interes tjetër është mbrojtja e pozitës të fëmijëve nëse vjen deri tek shkurorëzimi i asaj martese. *Së treti*, është risku ekonomik që mund të arrihet nga aktivitetet ekonomike që kryen secili prej bashkëshortëve, me qëllim kufizimin e

²⁰ Bürgerliches Gesetzbuch (BGB) Article §§ 1363–1390,

²¹ Ligji për familje i RM-së, neni 13-21

²² European Social Survey, Cikli mbi Qëndrimet Familjare, 2018; OECD Family Database, 2020.

²³ Ieva, “Le convenzioni matrimoniali.” f. 59-60.

përgjegjësisë pasurore të bashkësisë për detyrimet, që rëndojnë mbi pasurinë personale të bashkëshortëve.

Kontrata i kundërdrejtohet të tretëve. Në ndryshim nga parimet e përgjithshme të së drejtës private, kontrata martesore ka efekte “*erga omnes*”. Si përjashtim nga rregulli i përgjithshëm i fuqisë “*inter partes*” të kontratës, kontrata martesore mund t’i kundërdrejtohet çdo personi. Për këtë arsye, për mbrojtjen e interesave të të tretëve që kontraktajnë me bashkëshortët, në legjislacionet moderne sistemi i regjistrimit të kontratës martesore në regjistrat publikë. Kjo karakteristikë përfaqëson një tjetër ndryshim, ndërmjet kontratës martesore dhe kontratave të zakonshme të së drejtës civile, të cilat sjellin efekte vetëm për palët kontraktore. Sipas objektit të saj, kemi të bëjmë me “*veprim juridik kompleks*”, pasi, në përmbajtjen e kontratës martesore, bashkëshortët, jo vetëm që kanë të drejtë të rregullojnë regjimin pasuror martesor, të cilit do t’i nënshtrohet pasuria e fituar gjatë martesës, por mund të rregullojnë edhe marrëdhënie të tjera ndërmjet tyre, si dhurimet ndërmjet tyre apo dhurimet e të tretëve në favor të bashkësisë ose të bashkëshortëve, kontributi material për nevojat e familjes, pasojat e zgjidhjes së martesës²⁴. Sistemi i regjistrimit të kësaj kontrate parashikon regjistrimin e saj në aktin e martesës, regjistrin tregtar dhe regjistrin e pasurive të paluajtshme. Funkcioni i regjistrimit është mbrojtja e kreditorëve të bashkëshortëve dhe të tretëve, të cilët mund të futen në marrëdhënie juridiko-civile në të ardhmen me bashkëshortët. Kohëzgjatja e zbatimit të kontratës martesore varet nga “kohëzgjatja e martesës”. Është e kuptueshme që, kontrata martesore nuk mund t’i mbijetojë përfundimit të martesës. Palët gjithashtu mund të vendosin t’i japin fund regjimit pasuror martesore gjatë martesës duke e shfuqizuar atë, nëpërmjet vendosjes së një tjetër regjimi pasuror ose nëpërmjet shfuqizimit të kontratës.

Funksioni i kontratës martesore është kryesisht rregullimi i regjimit pasuror martesor, nëpërmjet një modifikimi të regjimit ligjor, ose nëpërmjet një regjimi krejtësisht të ndryshëm nga ai ligjor.

3. Statusi juridik i kontratës martesore në Maqedoninë e Veriut: problematika, boshllëqe dhe orientime reformuese

Në kohën kur shtetet bashkëkohore e kanë të inkuorporuar këtë institut dhe partnerët e ardhshëm martesor munden lirshëm të

²⁴ Zaka, “Kodi i ri i Familjes - Një hap në zhvillimin e marrëdhënieve familjare.” f.12; Mandro-Balili, Meçaj, Zaka, dhe Fullani, E drejta familjare, f. 321

rregullojnë çështjet pasurore, Maqedonia e Veriut ka ngecur 13 vite në përfundimin dhe miratimin e Kodit Civil në të cilin priten ndryshime ligjore sa i përket sferës së të drejtës familjare. Në legjislacionin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nuk ekziston një dispozitë specifike që të njohë ose rregullojë kontratën martesore si institucion juridik. Ligji i familjes i RMV-së nuk parashikon mundësinë që bashkëshortët të lidhnin një marrëveshje për regjimin pasuror të martesës së tyre. Ky boshllëk ligjor e bën kontratën martesore një koncept vetëm teorik dhe krahasues në kontekstin maqedonas, dhe çdo rregullim i marrëdhënieve pasurore gjatë martesës bazohet mbi normat e përgjithshme të pasurisë dhe ndarjes së pronës. Sipas Ligjit për pronësinë dhe të drejtat e tjera sendore, bashkëshortët, kanë të drejtë të lidhin kontrata për mënyrën e administrimit dhe disponimit me pronësinë e përbashkët, dhe atë të veçantë si edhe kontrata të tjera me të cilat nuk cenohet regjimi pasuror ligjor. Mundësia për të lidhur kontratë paramartesore apo martesore, sipas profesoreshës, do të nënkuptonte jo vetëm alternativë bashkëshortëve martesor/jashtëmartesor që sipas vullnetit të tyre të rregullojnë marrëdhëniet pasurore gjatë kohëzgjatjes së martesës /bashkësisë jashtëmartesore së tyre si dhe në rastin e pushimit të martesës, por edhe plotësimin e zbrazëtirave ligjore në lidhje me këtë çështje. Ky institut barazon bashkëshortët në aspektin e kontributit në krijimin e pasurisë në martesë, qoftë ai kontribut direkt (financiar) apo indirekt (jomaterial-ruajtja e fëmijëve, përkujdesja për amvisërinë, etj.) dhe eviton pabarazinë financiare të bashkëshortëve. Mirëpo, praktika gjyqësore në vendin tonë na dëshmon të kundërtën- kemi shumë pak raste ku pasuria e përbashkët është ndarë në mënyrë të barabartë për të dy bashkëshortët. Kjo flet për nivelin shumë të ulët të respektimit të dispozitave ligjore në marrëdhëniet martesore.”

3.1 Nevoja për përfshirjen e kontratës martesore në legjislacionin e Maqedonisë së Veriut: analizë juridike

Kjo dilemë paraqet një nga çështjet më të rëndësishme që pritet të hapet gjatë procesit të reformës së të drejtës familjare. Aktualisht, Ligji për familje nuk njeh një institucion të tillë juridik, gjë që e lë vendin prapa trendeve moderne të shumë sistemeve juridike evropiane, ku kontrata martesore është pjesë thelbësore e autonomisë së bashkëshortëve dhe e rregullimit të marrëdhënieve të tyre pasurore.

Në praktikën juridike të Republikës së Maqedonisë së Veriut, instituti i kontratës martesore nuk është i rregulluar si një instrument i

veçantë juridik, por paraqitet vetëm në mënyrë indirekte përmes parimit të lirisë së kontraktimit në marrëdhëniet e detyrimeve²⁵. Brenda këtij parimi, palët në martesë mund të rregullojnë me marrëveshje disa aspekte të marrëdhënieve pasurore, por ky rregullim nuk e ka karakterin e një “kontrate martesore” klasike, siç njihet në shumicën e legjislacioneve evropiane. Ky koncept rrjedh nga zgjidhjet e vjetra të sistemit socialist, në të cilat ka dominuar regjimi pasuror ligjor i martesës, i cili edhe sot mbetet modeli kryesor në të drejtën familjare maqedonase²⁶. Si rezultat, regjimi i pasurisë së bazuar në marrëveshje është shumë i kufizuar, ndërsa hapësira për autonominë e vullnetit të bashkëshortëve është minimale. Në këtë drejtim, legjislacioni maqedonas parashikon vetëm një lloj marrëveshjeje ndërmjet bashkëshortëve: marrëveshjen me të cilën rregullohet menaxhimi dhe dispozita mbi pasurinë e veçantë dhe të përbashkët. Megjithatë, praktika tregon se kjo marrëveshje pothuajse kurrë nuk lidhet, ndaj përbën një segment të parëndësishëm dhe jofunksional të rregullimit kontraktor të marrëdhënieve pasurore.²⁷ Kjo ndodh sepse: efektet juridike të një marrëveshjeje të tillë janë të kufizuara, nuk ekziston bazë ligjore për të rregulluar me kontratë çështje më të gjera pasurore, sistemi juridik nuk njuh mundësinë e zgjedhjes ndërmjet regjimeve të ndryshme pasurore (si në Gjermani, Francë, Itali, Slloveni, Kroaci etj.). Me fjalë të tjera, rregullimi kontraktor i të gjitha marrëdhënieve të tjera pasurore ndërmjet bashkëshortëve nuk është i lejuar me ligj, gjë që e kufizon zhvillimin e kontratës m martesore si institut modern juridik.²⁸

3.2 Sfidat juridike dhe sociale

Legjislacioni i Republikës së Maqedonisë së Veriut, i cili aktualisht rregullon marrëdhëniet pasurore ndërmjet bashkëshortëve përmes një sistemi të detyrueshëm ligjor të pasurisë së përbashkët, përballet me një sërë sfidash teorike dhe praktike nëse synohet futja e kontratës martesore (marital property agreement) si instrument juridik. Sfidat

²⁵ Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve i RM-së, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.18/2001, 5/2003, 84/2008, 81/2009

²⁶ Дејан Мицковиќ, Лилјана Стојкова, „Вонбрачната заедница во современите семејства“, Евродиалог 15/1999,

²⁷ Ангел Ристов, „Брачен договор – непознаница, реалност или нужност во современото македонско семејно право“, Зборник во чест на проф. Љиљана Спировиќ Трпеновска, Скопје 2013, f. 147–167

²⁸ Д. Мицковиќ, А. Ристов, Кодификација на семејното право во Република Македонија, Зборник радова „Владавина права и правна држава у региону“, Источно Сарајево 2014, f. 487-516.

rezultojnë nga tradita juridike, nga konceptet e konsoliduara të së drejtës familjare, si dhe nga faktorët socio-kulturore që ndikojnë drejtpërdrejt në pranueshmërinë e këtij instituti.

Një nga sfidat kryesore lidhet me mungesën e harmonizimit sistematik ndërmjet së drejtës familjare dhe të drejtës detyrimore. Kontrata martesore, në esencë, përfaqëson një marrëveshje kontraktuale që kërkon standarde të saktësuara të formës, transparencës dhe mbrojtjes së palës më të cënueshme. Legjislacioni maqedonas nuk ka ende dispozita të posaçme që rregullojnë procedurën e lidhjes, verifikimit, vlefshmërisë dhe kufijve të autonomisë kontraktore brenda marrëdhënieve martesore. Mungesa e këtij kuadri hap dilema lidhur me rolin e noterëve, kontrollin e pabarazive të mundshme kontraktore dhe parandalimin e abuzimeve. Sfidë e rëndësishme paraqet edhe ruajtja e parimit të barazisë së bashkëshortëve, i cili është i garantuar në Kushtetutë dhe në Ligjin e familjes. Futja e kontratave martesore mund të sjellë rrezik të krijimit të marrëdhënieve juridike të pabalancuara, veçanërisht në situata ku njëri bashkëshort është në aspektin ekonomik apo social i dobët. Legjislacioni duhet të parashohë mekanizma të qartë për të shmanjur nënshkrimin e marrëveshjeve nën presion, pabarazitë e tepruara në ndarjen e pasurisë, ose dispozita që cenojnë të drejtat themelore të bashkëshortit të mbrojtur.

Një tjetër sfidë përfshin mungesën e standardeve të brendshme për mbrojtjen e interesit të fëmijëve, pasi çdo marrëveshje që prek pasurinë familjare duhet të sigurojë që e drejta e fëmijëve për mirëqenie materiale të mos cenohet. Legjislacioni aktual nuk përcakton nëse dhe në ç'masë kontrata martesore do të mund të kufizohet në situata ku prek të mirën e fëmijës, as nuk parashikon rolin e gjykatave në kontrollin *ex post* të këtyre marrëveshjeve. Aspekt i veçantë problematik është mungesa e traditës juridike dhe kulturore për përdorimin e kontratave martesore. Në shoqërinë maqedonase, rregullimi i pasurisë martesore është historikisht i lidhur me modelin ligjor të pasurisë së përbashkët, i perceptuar si mekanizëm mbrojtës për bashkëshortin më të dobët. Futja e kontratave që lejojnë ndarje të pasurive apo rregullim autonom mund të përballlet me rezistencë sociale dhe me mosbesim, gjë që e vështirëson implementimin dhe zbatueshmërinë praktike.

Në nivel teknik-legjislativ, sfidë mbetet harmonizimi me standartet evropiane, duke qenë se shumica e vendeve të BE-së njohin kontratat martesore, por secila prej tyre ka mekanizma të zhvilluar për kontrollin e drejtësisë së marrëveshjeve, verifikimin noterial, regjistrat

publikë dhe mbrojtjen e palëve vulnerable. Maqedonia e Veriut ende nuk ka zhvilluar as regjistër të kontratave martesore, as mekanizma të posaçëm kontrolli preventiv.

Përfundimisht, sfidë e rëndësishme është nevoja për edukim juridik dhe institucional, si për qytetarët, ashtu edhe për profesionistët e drejtësisë (gjykatës, prokurorë, noterë, avokatë). Futja e kontratës martesore pa një infrastrukturë profesionale mbështetëse dhe pa informim të qartë për publikun mund të krijojë paqartësi, abuzime dhe pabarazi në zbatim.

Nga aspekti social ekzistojnë sfida të konsiderueshme që ngërthejnë edhe dimensione të thella sociale që lidhen me perceptimet kulturore, normat morale, pritshmëritë shoqërore dhe rolin tradicional të familjes në shoqëri. Në shoqëritë ballkanike, përfshirë edhe Republikën e Maqedonisë së Veriut, familja konsiderohet një institucion me karakter të fortë kolektiv dhe sentimental, ndaj çdo ndërhyrje juridike në marrëdhëniet bashkëshortore shpesh shoqërohet me vlerësime emocionale dhe sociale.²⁹ Në shumë raste, kontrata martesore perceptohet si shprehje e mosbesimit mes bashkëshortëve, duke u konsideruar e panevojshme ose madje e papërshtatshme për „njësinë“ familjare, e cila në mentalitetin tradicional pritet të mbështetet në besim dhe solidaritet emocional, e jo në marrëveshje juridike.³⁰ Ky perceptim social krijon rezistencë ndaj institucionalizimit të kontratës martesore, edhe kur ajo do të siguronte transparencë, barazi ekonomike dhe mbrojtje të interesave të të dy bashkëshortëve. Një tjetër dimension social lidhet me pozitën ekonomike të grave në shoqëritë tranzitore. Në shumë raste, gratë hezitojnë të kërkojnë kontratë martesore për shkak të presionit social, frikës nga stigmatizimi ose frikës se kjo mund të interpretohet si mungesë besimi ndaj partnerit.³¹ Kjo sjell si pasojë mungesën e mbrojtjes pasurore për gratë në rast divorci, veçanërisht në familjet ku gratë kontribuojnë në punë të papaguara në shtëpi, rol i cili nuk matet me vlerë ekonomike në mungesë të një marrëveshjeje pasurore të qartë.

Nga ana tjetër, në shoqëritë moderne perëndimore, kontrata martesore shihet si mjet i planifikimit financiar dhe si garanci për autonominë individuale, pa e cenuar institucionin e martesës. Kjo tregon se trajtimi social i kontratës martesore varet ngushtë nga zhvillimi socio-

²⁹ Studimet sociologjike mbi familjen në Ballkan, Institutet Rajonale për Shkenca Shoqërore.

³⁰ Raportet mbi barazinë gjinore në vendet e tranzicionit, Komisioni Evropian, 2022.

³¹ Analiza të organizatave për edukim juridik mbi nevojën e modernizimit të së drejtës familjare në RMV.

kulturore i shoqërisë dhe niveli i emancipimit ekonomik dhe juridik të qytetarëve. Në kontekstin e Maqedonisë së Veriut, futja e kontratës martesore në legjislacion do të kërkonte jo vetëm ndryshime normative, por edhe proces të gjerë edukimi juridik dhe shoqëror, me qëllim që të ndryshohen perceptimet tradicionale dhe të kuptohet se kontrata martesore nuk përbën kërcënim për familjen, por mjet që garanton qartësi, siguri juridike dhe barazi brenda saj.

4. Kontrata martesore në vendet e rajonit dhe Bashkimin Evropian - vështrim krahasues

Kontrata martesore, si instrument juridik, ka për qëllim rregullimin e marrëdhënieve pasurore ndërmjet bashkëshortëve. Ajo lejon palët të vendosin rregulla të ndryshme mbi pasuritë e tyre, përveç rregullave të përgjithshme të vendosura nga ligji civil. Në vendet e rajonit, si , Shqipëria dhe Kosova, kontrata martesore njihet juridikisht, por përdorimi dhe efektiviteti i saj shpesh hasin në sfida praktike dhe legjislative. Në krahasim, në shumicën e vendeve të BE-së, kontrata martesore është një praktikë e zakonshme dhe rregullohet qartë me ligje të detajuara civile.

4.1 Rajoni - sfidat dhe karakteristikat

Në Shqipëri, Kodi civil³² parashikon kontratat martesore si një mjet për rregullimin e pasurive të përbashkëta, por shpesh përdorimi i tyre është i kufizuar për shkak të mungesës së informimit dhe kostojve të lartë për formalizim. Në Kosovë, kontratat martesore³³ janë të njohura dhe lejojnë fleksibilitet, por ekziston një sfidë e ngjashme me zbatimin praktik dhe kontrollin efektiv nga gjykatat.

Në Kroaci³⁴, kontratat martesore rregullohen nga Kodi Civil Kroat (Obiteljski zakon) dhe mund të përcaktojnë regjime të ndryshme të pasurive: pasuri të përbashkëta, pasuri të veçanta, dhe rregulla për menaxhimin e tyre. Kontratat janë efektive vetëm nëse janë të shkruara dhe nënshkruara nga të dy bashkëshortët para noterit. Në praktikë, përdorimi i tyre është më i zakonshëm, sidomos për mbrojtjen e pasurive të trashëguara ose të fituara para martesës.

³² Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, Nr. 7850, 1994, me ndryshime dhe plotësime të mëvonshme.

³³ Ligji për Familje i Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-22, 2004.

³⁴ Obiteljski zakon RH, Narodne novine”, br. 116/2003

Në Serbi, kontrata martesore është e njohur nga Ligji për familje³⁵. Bashkëshortët mund të rregullojnë regjimin e pasurive të tyre gjatë martesës ose për pasuritë e veçanta. Kontratat martesore duhet të jenë me shkrim dhe të regjistrohen te gjykata për t'u bërë efektive. Një sfidë është përdorimi relativisht i kufizuar i tyre dhe njohja praktike në gjykata, sidomos kur kontratat përmbajnë dispozita të veçanta për ndarjen e pasurisë.

Legjislacioni i Malit të Zi, çështjen e regjimit pasuror dhe kontratës martesore e rregullon sipas Kodit civil³⁶ (Građanski zakonik) dhe lejojnë përcaktimin e regjimit pasuror, të pasurisë së përbashkët dhe asaj të veçantë. Kontrata duhet të jetë me shkrim dhe të regjistrohet te gjykata për t'u bërë efektive. Përdorimi është ende i kufizuar për shkak të njohjes së pamjaftueshme të instrumentit nga qytetarët dhe profesionistët juridikë.

Në Bosnje dhe Hercegovinë, situata është më komplekse për shkak të ndarjes administrative. Ligjet mbi kontratat martesore ndryshojnë midis entiteteve: Republika Serbe dhe Federata e Bosnjës dhe Hercegovinës kanë rregullime të ndryshme të Ligjit familjar. Në përgjithësi, kontratat martesore lejojnë rregullimin e regjimit pasuror, por për shkak të kompleksitetit ligjor dhe zbatimit të ndarë të ligjit, përdorimi i tyre praktik është i kufizuar dhe shpesh kërkon asistencë ligjore të specializuar.

4.2 Bashkimi Evropian – praktika dhe standardet

Në vendet e BE-së, kontratat martesore janë të njohura dhe të standardizuara në shumë

sisteme ligjore. Për shembull, në Gjermani dhe Francë, kontratat martesore mund të përcaktojnë regjime të ndryshme pasurore, duke përfshirë ndarjen e pasurive, administrimin e pasurisë gjatë martesës dhe dispozita të tjera për pasuri të veçanta³⁷. Në Itali dhe Spanjë, kontratat martesore përdoren shpesh për të mbrojtur pasuritë e trashëguara dhe për të përcaktuar ndarjen e pasurisë në rast divorci³⁸. Këto kontrata janë të detajuara ligjërisht dhe njihen nga gjykatat, duke siguruar siguri juridike për palët.

³⁵ Porodični zakon RS, Sl. glasnik RS”, br. 18/2005, 72/2011, 6/2015

³⁶ Građanski zakonik Crne Gore

³⁷ Codice Civile, Itali, kapitulli mbi regjimet e pasurive martesore; Código Civil, Spanjë, titulli mbi kontratat martesore.

³⁸ Bürgerliches Gesetzbuch (BGB), Gjermani, parashikimet për regjimet pasurore të bashkëshortëve.

Ndërkohë që në BE kontratat martesore janë të detajuara, të zbatueshme dhe të njohura gjerësisht, në vendet e rajonit ato përballen me sfida legislative dhe praktike:

- *Mungesa e standardizimit*: Në shumicën e vendeve të rajonit nuk ka modele standarde për kontrata martesore, gjë që krijon pasiguri.³⁹
- *Informimi i palëve*: Pak informacion dhe mungesë praktike për ndihmë juridike e bëjnë përdorimin më të vështirë.⁴⁰
- *Zbatimi gjyqësor*: Gjykatat shpesh nuk kanë praktikë të zhvilluar për interpretimin e kontratave martesore, duke çuar në vonesa dhe pasiguri.⁸
- *Integrimi me ligjet e tjera*: Ndërveprimi me ligjet për trashëgimi, pasuri dhe detyrime familjare shpesh nuk është i qartë.⁴¹

Conclusion

The prenuptial agreement is an important instrument for managing assets and protecting the interests of spouses—a well-known and even preferred legal option for partners who choose to share a life together in most countries around the world.

Contemporary comparative trends increasingly aim toward a free and dispositive regulation of reciprocal relations and the protection of individual interests within the marital or family collective, in accordance with the principle of legal certainty. In this way, prenuptial and marital contracts are gaining growing significance, not as a correction of the statutory property regime, but as an alternative property regime that predetermines the “rules of the game” within the union (according to the partners’ wishes and needs). Thus, the behavior and expectations between partners become predictable in advance, which helps prevent lengthy court proceedings regarding the division of joint property during cohabitation or in the event of the dissolution of the marital union.

³⁹ Shqyrtim krahasues i ligjeve të familjes në Ballkan, Revista Juridike Ballkanike, 2021.

⁴⁰ Analizë e praktikës gjyqësore në Maqedoni, Universiteti “Shën Kirili dhe Metodi”, Shkup, 2019.

⁴¹ Raport i Këshillit të Evropës mbi përdorimin e kontratave martesore, 2020.

A review of the legislation in the Republic of North Macedonia shows that the institution of the marital contract has not yet found its place in the national family law system. The property regime of spouses continues to be regulated exclusively through the universal statutory model, which applies equally to married couples and partners in non-marital unions. Although the current legislation allows limited agreements related to the management and disposal of joint property, these do not constitute a full contractual regime, as they cannot predetermine future property relations nor allow the selection of an alternative property model. A comparison with the countries of the region and those of the European Union clearly demonstrates that North Macedonia lags behind contemporary family-law trends. States such as Albania, Croatia, Slovenia, Serbia, and Montenegro, as well as most EU countries, have incorporated marital agreements as an integral part of spousal autonomy, enabling flexibility, legal certainty, and the avoidance of lengthy court disputes in cases of separation or divorce. The absence of marital contracts in the Macedonian legal system represents a significant gap, affecting both the private autonomy of individuals and the efficiency of the judicial system. The mandatory application of a single statutory regime does not reflect modern socio-economic realities, where spouses increasingly seek to regulate their property relations in a personalized manner. Moreover, the growing number of disputes over the division of joint property indicates that a more flexible model would contribute to preventing conflicts and strengthening legal certainty.

In this context, the introduction of the marital contract into the legislation of North Macedonia represents a necessity of the time. Such reform would harmonize the national legal framework with European standards, increase spousal autonomy, and contribute to building a fairer, more efficient legal system better prepared for the challenges of modern society, while facilitating the use of marital agreements for the protection of legal and social values.

Recensentë:

Prof. dr. Osman Kadriu

Prof. dr. Arlinda Kadri-Shahinoviq

Bibliografia:

1. Ангел Ристов, „Брачен договор – непознаница, реалност или нужност во современото македонско семејно право“, Зборник во чест на проф. Љилјана Спировиќ Трпеновска, Скопје 2013,
2. Analizë e praktikës gjyqësore në Maqedoni, Universiteti “Shën Kirili dhe Metodi”, Shkup, 2019.
3. Analiza të organizatave për edukim juridik mbi nevojën e modernizimit të së drejtës familjare në RMV.
4. Bariatti, Stefania. La famiglia nel diritto internazionale private comunitario. Milano: Giuffrè Editore, 2007
5. Bercovitz, S., Comparative Family Law in Europe, Oxford University Press, 2020
6. Cassano, Giuseppe. “Il diritto di famiglia nei nuovi orientamenti giurisprudenziali II, Il regime patrimoniale della famiglia.” në Trattati, P. Cendon, Milano: Giuffrè Editore, 2006
7. Cubeddu, Maria G. “Le convenzioni matrimoniali.” në I rapport patrimoniali tra coniugi III, T. Auletta (Ed.) në Trattati di diritto private, M. Bessone (Ed.), Torino: Giappichelli Ed., 2000.
8. Дејан Мицковиќ, Љилјана Стојкова, „Вонбрачната заедница во современите семејства“, Евродиалог 15/1999,
9. Дејан Мицковиќ, А. Ристов, Кодификација на семејното право во Република Македонија, Зборник радова „Владавина права и правна држава у региону“, Источно Сарајево 2014
10. Dubois, P., Le droit patrimonial de la famille, Paris, 2017
11. European Social Survey, Cikli mbi Qëndrimet Familjare, 2018; OECD Family Database, 2020.
12. Garofalo, I rapporti patrimoniali tra coniugi nel diritto internazionale privato, Rheinsteins dhe Glendon, “Intersposual Relations.
13. Kovačević, M., Porodično pravo, Beograd, 2018
14. Omari, Sonila. E drejta familjare. Tiranë: Botimet Morava, 2010
15. Raportet mbi barazinë gjinore në vendet e tranzicionit, Komisioni Evropian, 2022.
16. Russo, Le convenzioni matrimoniali ed altri saggi sul nuovo diritto di familia,
17. Shqyrtim krahasues i ligjeve të familjes në Ballkan, Revista Juridike Ballkanike, 2021.

18. The Max Planck Encyclopedia of European Private Law. Vol. II, J. Basedow, K.J. Hopt, R. Zimmermann, A. Stier (Eds.), Oxford: University Press, 2012,

19. Zweigert, K. & Kötz, H., Introduction to Comparative Law, 1998

Aktet juridike:

- Ligji për pronësi dhe të drejtat tjera sendore, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.18/2001, 92/2008
- Ligji për marrdhënjet e detyrimeve, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.11/2001, 4/2002, 5/2003, 84/2008, 91/2009
- Ligji për familje i RM-së, Gazeta zyrtare e RM-së nr. 80/92, 9/96,38/2004,33/2006, 84/2008, 67/10,156/10,39/12,44/12, 38/14, 115/14
- Ligji për pronësi dhe të drejta tjera sendore i RM-së, Gazeta zyrtare e RM-së, nr.
 - Ligji për trashëgimi i RM-së, Gazeta zyrtare e RM-së nr.47/96
 - Ligji për Familje i Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-22, 2004.
 - Bürgerliches Gesetzbuch (BGB), Gjermani, parashikimet për regjimet pasurore të bashkëshortëve.
 - Codice Civile, Itali, kapitulli mbi regjimet e pasurive martesore;
 - Código Civil, Spanjë, titulli mbi kontratat martesore.
 - Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, Nr. 7850, 1994, me ndryshime dhe plotësime
 - Obiteljski zakon RH, Narodne novine”, br. 116/2003
 - Porodični zakon RS, Sl. glasnik RS”, br. 18/2005, 72/2011, 6/2015

